



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
**MINISTRIA E INTEGRIMIT
EUROPIAN**

Mblidhet Komiteti i përbashkët për Integrimin European, mes Shqipërisë dhe Malit të Zi

2017-04-07 14:07:00



U zhvillua sot mbledhja e dytë e Komitetit të përbashkët për Integrimin European, mes Shqipërisë dhe Malit të Zi. Ministria Gjoshë, hapi këtë takim duke shprehur vlerësime për bashkëpunimin e shkëlqyer mes dy vendeve në nivel politik dhe nivel ekspertësh.

Ministrja Gjoshë: Të angazhuar për reformën në drejtësi, zbatimin përmes kapitujve të shtetit të së drejtës

“Eksperiencia e Malit të Zi me negociatat ndihmë për Shqipërinë. Bashkëpunimi rajonal thelbësor për integrimin e vendeve tona.

U zhvillua sot mbledhja e dytë e Komitetit të përbashkët për Integrimin European, mes Shqipërisë dhe Malit të Zi. Ministria Gjoshë, hapi këtë takim duke shprehur vlerësime për bashkëpunimin e shkëlqyer mes dy vendeve në nivel politik dhe nivel ekspertësh.

Ministrja theksoi rëndësinë që ka për qytetarët bashkëpunimi në programet e financuara nga Bashkimi European, duke nënvizuar se falë këtyre programeve impakti në jetën e qytetarëve është i drejtpërdrejtë.

“Vizioni ynë i përbashkët për të qenë pjesë e Bashkimit European, na lidh ngushtësisht me njëri-tjetrin, por unë besoj fort se ajo që na lidh më shumë është fqinjësia jonë e mirë të cilën duhet ta ruajmë e ta thellojmë sepse vetëm kështu do të mund ta kemi më të lehtë çdo hap që hedhim”, tha Ministria.

Duke u ndalur tek dokumenti për çeljen e negociatave, Ministria u shpreh se eksperiencia nëpër të cilën Mali i Zi ka kaluar dhe po kalon që nga hapja e negociatave, është shumë e vlefshme për institucionet shqiptare, sepse është një histori suksesi, që duhet ndjekur.

“Ne jemi të angazhuar për zbatimin e reformës në drejtësi dhe shpresojmë se një pjesë e konsiderueshme e saj si dhe forcimi i mëtejshëm i historikut të hetimeve (*track record*) në luftën kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit, do të kryhet në kuadër të negociatave për kapitujt 23 dhe 24, që janë kapitujt të cilët ne dëshirojmë ti hapim të parët”, tha Ministria.

Ministrja u shpreh se mbetet i një rëndësie të veçantë bashkëpunimi në kuadër të Procesit të Berlinit, duke nënvizuar se në samitin e Triestes duhet të konkretizohen projektet e përbashkëta të cilat i shërbejnë zhvillimit ekonomik, qytetarëve dhe rrjedhimisht procesit të integrimit të këtyre vendeve.